



**PUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
LIPJAN**



**KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF**

4-Nr. *~111-15195*

Datë ; 27.03.2017

Në mbështetje të Ligjit për Arsim në Komunitet të Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, të datës 21 maj 2008, 02.03.2017, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/040 dhe Ligjit për Arsimin dhe aftësimin e të Rriturve neni 16.1 MASHT, Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit shpall :

Konkurs

Për regjistrimin e vijueseve në Programin "Arsimi për të Rritur" në arsimin e mesëm të lartë klasa e X (dhjetë) në SHMP "Adem Gllavica"-Lipjan

1. Drejtimi: Administratë

Profili: Asistent Juridik

2. Bujqësi

Profili: Agrobiznes

Kushtet:

Regjistrimi i vijuesve në Programin "Arsimi për të Rritur" bëhet sipas procedurave të njëjta për nxënësit e rregullt, siç është paraparë në nenin 10.2 , pikat (a , b) dhe nenit 17.3 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë.

Në Programin " Arsimi për të Rritur " në shkollat e mesme të larta , vijuesve ju mundësohet mësimi sipas : UA . 12/2011 , datë:30.12.2011. neni 4

1. Mësimi intensiv me kohëzgjatje 18 javë (mund të kryhen dy vite brenda një viti shkollor.
2. Provime diferenciale (provimet mbahen për dy vite brenda një afati)
3. Mësim konsultativ me 10% të orëve të mësimit të rregullt.

Për regjistrim kanë të drejtë të gjithë të interesuarit të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt .

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

1. Dëftesat e klasave të kryera paraprake
2. certifikata e lindjes
3. Fletë pagesat nga participimi

Pagesa

Shkollimi në nivelin e Arsimit të mesëm të lartë është me pagesë , participimi behet në bazë të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.11/2011,të datës:30.12.2011.

Pagesat bëhen në xhirollogarinë përkatëse të institucionit përmes bankës (ceket emri shkollës , vendi dhe qëllimi i pagesës)

Pagesa për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimit për të rritur në shkollat e mesme të larta profesionale do të jetë:

- | | |
|--|----------|
| 1. Për regjistrim të vitit për një klasë----- | 100.00 € |
| 2. Për praktikë profesionale----- | 50.00 € |
| 3. Provimi diferencial----- | 10.00 € |
| 4. Për provimin përfundimtar të klasës , certifikatën----- | 50.00 € |
| 5. Për diplome të përfundimit të shkollimit----- | 20.00 € |

Kandidatet të cilët e ndërron drejtimin janë të obliguar që paraprakisht të u nënshtrohen provimeve plotësuese diferenciale.

Denja e provimeve plotësuese dhe diferenciale behet në afat të veçantë nga vijimi i klasës për të cilën kandidati është paraqitur për regjistrim.

Diplomat që merren në programin "Arsimi dhe Aftësimi për të Rritur" janë të barasvlershëm me diplomat e arsimit formal.

Konkursi mbetet i hapur 7 ditë nga dita e publikimit në Web-faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit

Te interesuarit për këtë shkollim , mund të aplikojnë për çdo ditë pune prej Orës : 8:00 – 15:00 , në shkollën e mesme profesionale " Adem Gllavica " Lipjan ,ose mund të na kontaktoni në këta numra telefoni: 038-581-023 ;044/219-775.

27.03.2017
Lipjan

